

## KARTE TEKNOLOGJIKE

### KRASITJA E PEMËVE FRUTORE BËRTHAMORE ( Specifikat per cdo specie )

Krahas punimeve, shpërndarjes së plehut, trajtimeve dhe krasitja është një proces mjaft i domosdoshëm me qëllim, për të mbajtur në bimë (dhe ruajtur ekuilibrin midis sistemit vegetativ “mbitokësor”, dhe atij rrënjor “nëntokësor”), dhe për të dhënë një prodhim të rregullt, me tregues të mirë cilësor, të bollshëm e të përvitshëm.

#### OBJEKTIVI KRYESORI KRASITJES :

Rregullimi i aktivitetit vegetativ e prodhues të pemëve frutore në favor të rritjes së prodhimit të qëndrueshëm e përmirësimit të cilësisë së tij

#### QELLIMET E KRASITJES

1. Krijimi i formave të përshtatshme të kultivimit në vartësi të karakteristikave të kultivarit, të kushteve të ambientit dhe të drejtimit të prodhimit.
2. Rregullimi i raportit në mes të rritjes dhe prodhimit për të garantuar prodhime të qëndrueshme sasiore e cilësore duke evituar prodhimin periodik
3. Të krijoj forma të qëndrueshme të kurorave të pemëve

#### BAZAT FIZIOLOGJIKE TE KRASITJES

1. Konkurrenca në mes të degëve të ndryshme të kurorës.
2. Raporti në mes të kurorës e të madhësisë dhe shtrirjes së aparatit rrënjor.
3. Raporti në mes rritjes vegetative dhe zhvillimit (prodhimit) në bimë.

#### TIPET E KRASITJES SIPAS TEKNIKËS SË REALIZIMIT TË TYRE

1. Krasitje formuese
2. Krasitje prodhuese
3. Krasitje rigjeneruese
4. Krasitje shëndetsuese

#### TIPET E KRASITJES SIPAS PERIUDHË

1. Krasitja dimërore
2. Krasitja e gjelbër.

#### TIPET E KRASITJES SIPAS NGARKESËS ME SYTHA

1. Krasitje e fuqishme (e varfër, me pak sytha)
2. Krasitje e dobët (e pasur, me shumë sytha)


#### TIPET E KRASITJES SIPAS GJATËSISË SË DEGËVE

## KARTE TEKNOLOGJIKE

1. Krasitje e gjatë (kur lihen degë të gjata)
2. Krasitje e shkurtër (kur lihen degë të shkurta)



**KRASITJA PRODHUESE E RREGULLT:** **Eliminohen** degët me rritje të fuqishme duke lënë të zhvillohen degët poshtë pikës së prerjes në mënyrë që të frenohet rritja e bujshme në lartësi të bimës duke mundësuar lehtësimin e kurorës nga degët e tepërta e duke përmirësuar raportin në mes të degëve prodhuese e atyre vegjetative në favor të degëve prodhuese. Përmirëson ndjeshëm cilësinë e frutave.



### **KRASITJA PRODHUESE E GABUAR:**

Prerja e majave të degëve e cila ul prodhimin, prish cilësinë e frutave, dhe detyron bimën të prodhojë shumë degë jo prodhuese duke rritur në mënyrë të bujshme kurorën në dëm të zhvillimit uniformë të saj.

### VEÇORITË E KRASITJES TEK PJESHKA

TEKNIKA E REALIZIMIT TË KRASITJEVE TEK PJESHKA PËRVEÇ FAKTORËVE TË PËERMENENDUR MË SIPËR VARET NGA FORMAT E KULTIVIMIT TË BIMËVE


#### **1.Format kupore të krasitjes:**



**Bima ka 3-5 krahë të përthërsur në këndin 45° Lartësia e bimës 2,5-3,0 m**

## KARTE TEKNOLOGJIKE

**2. Forma me udhëheqës qëndror 3. Forma Palmetë e lirë 4. Forma me parete të inklinuara**



## VEÇORITË E KRASITJES TEK QERSHIA

EDHE TEK QERSHIA KRASITJA VAREN NGA FORMAT E KULTIVIMIT TË BIMËVE DHE NËNSHARTESAT

Në frutikulturën moderne krasitjet dimërore kufizohen vetëm në prerje të veçanta të degëve që mund të krijojnë probleme mbasi mbyllja e plagëve të krasitjes në këtë specie është shumë e ngadaltë, ndërhyrje e cila rrit dëmet nga gomoza

FORMAT E KRASITJES TEK QERSHIA PERVEÇ SASISË E CILËSISË SË PRODHIMIT PËRCAKTOJNË DHE SHKALLËN E MEKANIZIMIT TË NDËRHYRJEVE AGRONOMIKE E KRYESISHT TË VJELJES SË FRUTAVE



## KARTE TEKNOLOGJIKE

FORMAT E KULTIVIMIT TEK QERSHIA MUND TË JENË: KUPORE E ULËT, PALMETË, FORMA FLAMUR ETJ

FORMA E LIRE E KRASITJES



Nënshartesat duhet të jenë me rritje të fuqishme dhe bimët duhet të kultivohen në zonat fushore

FORMA E KULTIVIMIT VAZO E ULËT

Nënshartesat duhet të jenë të fuqishme ose gjysëm xhuxhe dhe terreni fushor



Nënshartesat duhet të jenë të fuqishme ose gjysëm xhuxhe dhe terreni fushor

FORMA TË REJA TË KULTIVIMIT TË QERSHISË



PËRGJITHSISHT FORMA TË ULTA ME DENSITET TË LARTË

VECORITE E KRASITJES TEK KUMBULLA

FORMAT E KULTIVIMIT TEK KUMBULLA SYNOJNË TË LEHTËSOJNË MEKANIZIMIN, TË KRIJOJNË MUNDËSI TË MËDHA DRITËZIMI, TË PËRMIRËSOJNË CILËSINË E FRUTAVE DHE TË LEHTËSOJNË PËRTËRITJEN E BIMËS NËPËRMJET ELIMINIMIT TË PJESËVE TË PADOBISHME SHUMËVJEARE

## KARTE TEKNOLOGJIKE



vecorite e krasitjes se pemëve të kajsisë

përgatitja e bimëve dhe formimi i kurorave të tyre fillon menjëherë 1.

1.mbas mbjelljes në vendin e përhershëm



faza 1

faza 2.

faza 3

faza 4



faza 5

faza 6.

faza 7

faza 8.

**2.** mbas shpërthimit të lastarëve të ri  
nj bimët paraqiten në nje gjëndje të tillë

3.gjatë vegetacionit pjesa nën lartësinë e trupit  
pastrohet nga lastarët

3.duke i eliminuar ato kur janë akoma të vegjël gjithnjë nën lartësinë e projektuar të trupit

4. eliminimin e lastarëve në brendësi të kurorës...

5. krahët e ardhshëm përkulen dhe shtrihen në një kënd 45°

**6.** mbasi degët përkulen vetë nën peshën e vegetacionit e të  
prodhimit (në rastin kur bimët ngarkohen edhe me fruta për  
shkak të kushteve të favorshme të kultivimit

## KARTE TEKNOLOGJIKE

7. nga fundi i vegjetacionit fillon zgjedhja dhe përgatitja e krahëve të përhershëm

8. degëve kryesore nuk duhet tu priten majat

9. këtu përfundon formimi i kurorës dhe vazhdohet më vonë me krasitjet e përvitshme prodhuese

gjatë vegjetacionit thithakët në brendësi të kurorës duhet të eliminohen me anë të krasitjeve verore të cilat duhet të kryhen rregullisht mbasi ato rriten bujshëm në kurriz të ekuilibrit vegjetativ e prodhues të bimës. prerjet duhet të JENË TË PASTRA SEPSE MUND TË PROVOKOJN3 “GOMOZËN”

Pergatiti  
Athina Llambro

Dhjetor 2016